



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:236295

Datë: 02.12.2024

Numri i dokumentit: 06535028

**CN.nr.163/23**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN** – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Berat Spahiu, në çështjen juridike sipas padisë së paditësit S.O., kundër të paditurës Komuna e Gj., për anulimin e vendimit preliminar, jashtë seancës gjyqësore, më datë 02.12.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit S.O., e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Gj, për anulimin e vendimit preliminar.

**A r s y e t i m**

Paditësi S.O. nga Gjilani ka ushtruar padi në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Gj., për anulimin e vendimit preliminar.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka konstatuar se në këtë çështje kemi të bëjmë me shpronësim, andaj konform Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, paditësi është dashur që të ushtrojë ankesë, ashtu që përmes Aktvendimit CN.nr.163/23, i dt. 24.10.2024, ia ka kthyer në plotësim padinë e datës 26.10.2023, duke e njoftuar se nëse parashtrësia nuk i kthehet gjykatës brenda afatit ligjor, do të konsiderohet se është tërhequr, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, do të hedhet poshtë.

Nga shkresat e lëndës ekziston prova, përkatësisht fletëdërgesa për dorëzim personal, me të cilën vërtetohet se paditësi e ka pranuar në mënyrë të rregullt aktvendimin e dt. 24.10.2024, ndërsa nuk ka dorëzuar asnjë parashtrësë në gjykatë në afatin e paraparë konform këtij aktvendimi.

Andaj, gjykata, duke zbatuar në mënyrë analoge dispozitat e nenit 102.3 të LPK-së, ku është përcaktuar se “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë”, e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit.

Nga shkaqet e paraqitura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2023:236295, 02.12.2024**

**Gjyqtari**  
**Berat Spahiu**

**Udhëzim mbi mjetin juridik:** Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate.